

## Shenjat e sigurisë:

(Rregullorja (MPMS) nr: 4/2016)

- Shenjat e Sigurisë dhe shëndetit ofrojnë informacione ose udhëzime rreth sigurisë e shëndetit në punë në objekte, aktivitete ose situata specifike,
- Llojet: permanente – tabelat e sigurisë, ngjyrat e sigurisë, kohëpaskohe – ndriçuese, akustike dhe sinjale të dorës, komunikim verbal,
- Ngjyrat e shenjave: e kuqja- rrezik, e verdha-kujdes, e gjelbra-siguri, e kaltër- informacion,
- Punëdhënësi arranzhon zhvendosjen e shenjave të sigurisë kur kalon rreziku.



## Ambientet shpërthyes:

(Rregullorja (MPMS) Nr. 5/2016)

- Risqet nga shpërthimet: flaka, efektet e presionit, copëzat, produkte të dëmshme nga reagimet, mungesë e oksigjenit në ajër,
- Tri elemente të shpërthimit: burim ndezjeje, oksigjen, lëndë djegëse të ndezshme,
- Derivate shpërthyes: gazi i ndezshëm, avulli, mjegull, pluhur, lëng, përzierja e tyre,
- Masat parandaluese: identifikimi i rrezikut dhe vlerësimi i tij, të siguruarit e ambientit të sigurtë të punës dhe mbikëqyrja në prezencë të rrezikut, koordinim kur disa firma operojnë njëkohësisht.



## Azbesti:

- Rreziqet kyqe: fibra të imëta nga pluhuri i azbestit, koncentrimi i lartë për kohë të gjatë,
- Konsekuencat vijnë pas një kohe të gjatë prej 15 – 40 vite: azbestozë, kancer të mushkërive, kancer në eshtra dhe në lukth,
- Masat: shmangie nga puna me azbestë kur ka mundësi, përdorimi i pajisjeve mbrojtëse personale: respiratori, gjithë trupi, dorëza, çizme, pastrimi, kontrollë mjekësore, trajnim e informim,
- Masat paraprake: Njoftim te autoritetet, plan pune, plan për mbeturina, pastrimi i hapësirave të punës dhe verifikim, ndërmarrje masash, Çertifikim Mjekësor i punëtorëve.




Në rast ankese ose nevojës për informatë

Thirrni INSPEKTORATIN E PUNË  
(0800 77577)



Ky projekt financohet nga Bashkimi Europian

## Informohuni mbi legjislacionin e ri!




Implementuar nga:



ARCHIDATA

## Vendpunishtet e ndërtimit:

- Rreziqet kryesore: rënia nga lartësia, aksidente me automjete, shoku elektrik, shembja e dheut gjatë gërmimeve, goditje nga materiale të forta, kontakt me substanca të rrezikshme,
- Shkaqet: organizatë e pakënaqur, planifikim i dobët, injorim i rregullave elementare nga punëtorët, mbikëqyrja e dobët,
- Pjesëmarrësit: investitorët dhe kontraktorët, koordinatori, furnizuesit e materialeve, përfaqësuesit e punëtorëve,
- Masat: emërimi i koordinatorëve, mbikëqyrësve.



## Ekran Shfaqës:

(Rregullorja (MPMS) nr: 6/2016)


- Komponentet e Vendpunishtes: ekranët shfaqës, taste, mouse, mbajtës dokumentesh, karrika, tavolina, mbajtëse këmbësh e duarsh, bateri, reflektorë,
- Konsekuencat: Çrregullime musculoskeletale dhe qarkullimi i gjakut, dëmtim i të pamurit, lodhje, stres, çrregullim metabolizmi,
- Obligimet e punëdhënësit ndaj kujdesit për inventarin dhe planin e hapësirës, Hardware dhe Software, organizimin e punës, ambientin e punës, pushimet dhe ushtrimet, trajnimin e punëtorëve si të ulen, lexojnë, lëvizin, pushojnë,
- Punëtorët duhet të vendosin shprehi të mirë të përditshme të punës me ekrane shfaqëse !



## Pajisjet Personale Mbrojtëse (PPM):

(Rregullorja (MPMS) Nr. 2/2016)

- Me qëllim të ofrimit të sigurisë së të punësuarve punëdhënësi duhet: 1 - zhvendosje rreziku, 2 - zvogëlim rreziku, 3 - mbrojtje kolektive, 4 - përdorimi i pajisjeve personale mbrojtëse,
- Mbrojtja: koka, dëgjimi, sytë dhe fytyra, frymëmarrja, duart e krahët, këmbët dhe shputat, lëkura, gjithë trupi,
- Punëdhënësi ofron pajisje personale mbrojtëse për punëtorët sipas vlerësimit të rrezikut, falas, siguron informim dhe trajnim për punëtorët, mirëmbajtje dhe pastrim të pajisjeve personale mbrojtëse, përdorim të pajisjeve të certifikuara.



## Zhurma:

Rregullorja (MPMS) Nr. 2/2017)


- Sektorët me rrezik të lartë: manufakturi, miniera, transporti,
- Kërcënimet nga zhurma dhe kohëzgjatja e ekspozimit
- Pasojat: probleme me dëgjim, stres, humbje dëgjimi,
- Masat: përpjekjet për shmangje ose zvogëlim të ekspozimit, përcjelljet e kufizimeve ndaj ekspozimit, mbrojtja personale, kontrolli shëndetësor, dizajni i vendit të punës, blerja e pajisjeve të punës pa zhurmë,
- Punëdhënësi është përgjegjës për vlerësimin e rrezikut nga zhurma.



## Punë krahu

(Rregullorja (MPMS) nr: 3/2016)

- Rreziqet: mbajtja ose bartja e peshave të rënda, lëvizja e përsëritshme e dorës apo krahut, pozita me dhembje e lodhje,
- Konsekuencat: çrregullime musculoskeletale, paaftësi pune, dhembje shpine, qafe, këmbësh e krahësh, kokëdhembje,
- Shmangje: përkulje dhe kthesë, mbingarkesë, pozitë e sforcuar, temperaturë e ulët, përsëritje,
- Përdorni trajtimin ergonomik me ngarkesa - me përdorimin e këmbëve, jo me shpinë të përkulur,
- Punëdhënësi instalon asistencë mekanike kur është e mundur.



## Dridhjet:

Rregullorja (MPMS) Nr. 1/2017)

- Kërcënime nga dridhja e tërë trupit dhe e krahut të dorës,
- Masat: Zvogëlimi i nivelit të ekspozimit të dridhjes duke inkorporuar masat parandaluese në dizajnin e vendit të punës apo vendpunishteve dhe duke përzgjedhur pajisjet e punës,
- Dhënia e prioritetit në zvogëlimin e rrezikut në burim, përcjellja e kufizimeve në ekspozim, ofrimi i kontrollit shëndetësor, pajisjeve mbrojtëse personale, informimi.

